



DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE



**European Bank**  
for Reconstruction and Development

# INFORMACION PËR TATIMPAGUESIT

Person Juridik me xhiro  
mbi 2 deri 5 milionë Lekë

# Shoqëri tregtare me xhiro mbi 2 deri 5 milionë Lekë

## 1. Quresh shoqëri tregtare nëse:

- Preferon të bësh biznes si person juridik dhe jo si individ, person fizik;
- Harton një statut të shoqërisë, si individ ose me persona të tjerë fizikë (individë) dhe/ose si person i vetëm juridik ose me persona të tjerë juridikë, në të cilin vendosen objektiva ekonomike të përbashkët dhe kontributet financiare të secilit pronar;
- Regjistrohesh në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të fituar personalitet juridik; dhe,
- Merr përgjegjësi për detyrimet e krijuara gjatë ushtrimit të veprimtarisë me të gjitha pasuritë (aktivet) e biznesit.

Për të zgjedhur formën më të përshtatshme të biznesit kliko në faqen elektronike të QKB:

<http://www.qkb.gov.al/informacion-mbi-proceduren/regjistri-i-biznesit/regjistrimi-fillestar/>

## 2. Regjistrimi i biznesit në QKB është i detyrueshëm:

- Brenda 30 ditëve kalendarike nga data e themelimit; dhe,
- Gjithmonë para nisjes efektive të veprimtarisë së shoqërisë,

## 3. Vendet ku mund të regjistrohesh:

- Në sportelet e QKB-së ose të autorizuara prej saj në bashki dhe dhomat e tregtisë;
- Në sportelet e Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA); dhe,
- Në platformën elektronike e-albania.



#### 4. Për regjistrimin e biznesit kërkohen disa dokumenta dhe të dhëna të detyrueshme:

##### a. Dokumentat:

- i. Kartë identiteti e administratorit ose personit të autorizuar prej tij;
- ii. Akti i themelimit dhe statuti nëse janë hartuar si dy dokumente të veçanta;
- iii. Kartat e identitetit të ortakëve që nuk janë të cituara në aktet e krijimit të shoqërisë;
- iv. Dokumenta të tjera specifike për ortakët e shoqërisë që janë persona juridikë.

**Kujdes:** Në platformën e-albania ndiqen udhëzimet për mënyrën e aplikimit.

##### b. Të dhënat minimale të detyrueshme për t'u përfshirë në statutin e një shoqërie tregtare shpk dhe formularin e kërkesës për regjistrim:

- i. Emri;
- ii. Lloji i aktivitetit;
- iii. Adresa;
- iv. Ortakët;
- v. Kapitali fillestar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë;
- vi. Vlera e kuotës së zotëruar nga secili ortak;
- vii. Administratori;
- viii. Kohëzgjatja e shoqërisë.

##### c. Xhiroja vjetore e parashikuar:

Përbën bazën mbi të cilën përcaktohen detyrimet/përgjegjësitë tatimore që në momentin e regjistrimit.

Më tej paraqiten llojet e detyrimeve tatimore sipas nivelit të xhiros.

REGJISTRIMI I  
TATIMPAGUESVE

**Tabela 1 – Llojet e detyrimeve tatimore në varësi të xhiros vjetore të biznesit**

Xhiroja Vjetore (Në lekë)	Përgjegjësitë tatimore / Llojet e Detyrimeve Tatimore				
	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore dhe TAP	Tatim mbi Vlerën e Shtuar (TVSh)	Tatim mbi Fitimin e Thjeshtuar	Tatim Mbi Fitimin	Tatimi në Burim
0-2 milionë	Po	Jo	Po	Jo	Po
<b>Mbi 2 deri 5 milionë</b>	<b>Po</b>	<b>Po</b>	<b>Po</b>	<b>Jo</b>	<b>Po</b>
Mbi 5 deri 8 milionë	Po	Po	Po	Jo	Po
Mbi 8 milionë	Po	Po	Jo	Po	Po

**5. Procesi i regjistrimit në QKB përfundon mbasi ke:**

- plotësuar dhe dorëzuar formularin e regjistrimit me të dhënat e mësipërme;
- Dorëzuar të gjitha dokumentat shoqërore; dhe,
- Marrë dokumentin unik të identifikimit, që quhet Numri i Identifikimit të Personit të Tatuashëm (NIPT), dhe certifikatën përkatëse të regjistrimit.

**Ky proces zgjat një ditë pune.**

Të nesërmen mund të verifikosh statusin e kërkesës për regjistrim duke klikuar në faqen elektronike të QKB-së: <http://www.qkb.gov.al>

- Në rast se kërkesa pezullohet, ke 21 ditë kohë për të plotësuar mangësitë.
- Në rast se regjistrimi refuzohet, bëhet kërkesë e re, pas eliminimit të shkaqeve të refuzimit.

**6. Regjistrimi i biznesit në QKB është njëkohësisht edhe:**

Regjistrim në Administratën e Tatimeve, Doganave, Bashkive dhe Inspektoratit të Punës.

**7. Menjëherë pas regjistrimit fillestar në QKB:**

- Hap dhe regjistro llogarinë tënde në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) duke përdorur:
  - NIPT-in, si emër përdoruesi, dhe
  - “Tatimetemia12”, si fjalëkalim fillestar.

**Kujdes:**

1. Përgjegjësitë tatimore fillojnë nga data e regjistrimit në QKB.
2. Verifiko dhe qartësohu për përgjegjësitë tatimore të listuara në kategorinë “Profili im”.
3. Deklarimet për detyrimet tatimore bëhen vetëm nëpërmjet kësaj llogarie elektronike.
4. Nëse keni probleme gjatë regjistrimit dhe përdorimit të llogarisë tuaj elektronike:
  - a) Telefoni Qendrën e Thirrjeve të DPT në numrin e telefonit 0800 00 02;
  - b) Merr udhëzime drejtpërsëdrejti në seksionin “live chat” të këtij shërbimi;
  - c) Paraqitu personalisht pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore (DRT), ose
  - d) Kliko në faqen elektronike të DPT: <https://www.tatime.gov.al/c/7/200/udhezues-perdorimi>

**8. Menjëherë pas hapjes dhe regjistrimit të llogarisë elektronike në DPT:**

- a. Brenda dy ditëve pune pas regjistrimit në QKB, duhet të regjistroh administratorin në seksionin e listë-pagesave të llogarisë tënde elektronike tek faqja elektronike e DPT;
- b. Shko pranë Zyrës së Taksave Vendore të Bashkisë tënde:
  - i. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit;
  - ii. Kërko njoftimin për llojet, shumat dhe afatet e pagesës së taksave të tua vendore.

**Kujdes:** Nëse ambientin e merr me qera, pronari duhet të ketë paguar taksën e pasurisë së paluajtshme.

- c. Shko në DRT për:
  - i. T’u pajisur me bllokun e faturave tatimore të shitjes me TVSh, dëftesat tatimore dhe faturat e shoqërimit të mallit; dhe
  - ii. Dorëzo një kopje të aktit të pronësisë/kontratës së qerasë për vendin/vendet e biznesit.
- d. Shkarko modelin e deklarimit të librave të blerjes dhe shitjes, nga seksioni “Librat e shitjeve dhe blerjeve” në llogarinë tënde elektronike në DPT;



- e. Brenda 15 ditëve nga data e regjistrimit duhet të pajisesh me kasë fiskale, pranë shoqërive të autorizuara, nëse do të shesësh me para në dorë;


**Kujdes:** Deri në ditën e pajisjes me kasë fiskale dhe/ose në rast se kasa fiskale është jashtë funksionit, duhet të lëshosh dëftesë tatimore për çdo shitje të kryer.

- f. Hap llogari bankare të shoqërisë për arkëtimet dhe pagesat e biznesit tënd.

**Kujdes:** Nuk mund të bëhen transaksione me para në dorë për shuma mbi 150,000 lekë midis dy personave tregtarë fizikë apo juridikë.

## 9. Në marrëdhënie me administratën tatimore ke të drejtë për:

- a. Informim dhe sqarim për legjislacionin;
- b. Ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave tua;
- c. Marrje njoftimi paraprakisht për aktet që lidhen me detyrimet tatimore;
- d. Kontrollë tatimore në kohë të arsyeshme, në vendin e duhur dhe brenda afateve të ligjit;
- e. T'u dëgjuar para marrjes së vendimeve që lidhen me biznesin tënd;
- f. Të marrë informacion nga dosja jote tatimore;
- g. Përfaqësim me persona të autorizuar prej teje;
- h. Ankimim ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës;
- i. Një shqyrtim të pavarur administrativ të ankesave të bëra;
- j. Marrë ose printuar nga sistemi elektronik (e-albania) vërtetime për:
  - i. Përgjegjësitë tatimore;
  - ii. Detyrimet e paguara;
  - iii. Pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
  - iv. Xhiron e 3 viteve të fundit;
  - v. Statusin si tatimpagues (aktiv, pasiv) dhe afatet konkrete për secilin rast;



- vi. Posedim mjeti.
- vii. Për regjistrim të investitorit;
- viii. Për kontributet e paguara për individin;
- ix. Vërtetim për individë të peregjistruar.

## 10. Dokumentat që duhen afishuar në ambientet e biznesit:

- a. Certifikata e Regjistrimit (NIPT-i);
- b. Lista e çmimeve të shitjes për çdo mall/shërbim që ofron;
- c. Njoftim-kujdes për klientët që të marrin kuponin tatimor për blerjet me para në dorë si dhe që kanë të drejtë për të mos kryer transaksionin për vlerën e mallit ose shërbimit të ofruar, nëse shitësi nuk lëshon faturën tatimore ose kuponin tatimor.

## 11. Për dokumentimin e shitjeve dhe blerjeve duhet të:

- a. Lëshosh kupon tatimor për çdo shitje me para në dorë;
- b. Lëshosh faturë tatimore shitje me TVSh, së bashku me kuponin tatimor kur:
  - i. Shet mallra apo ofron shërbime me vlerë mbi 40.000 lekë;
  - ii. Bën shitje tek një tregtar tjetër, dhe
  - iii. Blerësi individ të kërkon vetë një faturë tatimore me TVSh.
- c. Lësho faturë tatimore shitje me TVSh në rast se:
  - i. Shet mallra ose kryen shërbime me pagesë të mëvonshme në bankë;
  - ii. Arkëton paradhënie për shitje mallrash ose kryerje shërbimesh në një datë të mëvonshme.
- d. Lësho faturë tatimore nga blloku yt, me shënimin “Faturë e lëshuar nga blerësi”, për blerjet që bën nga individë, persona fizikë jo-tregtarë, dhe shëno në të numrin e kartës së identitetit të tij, në mënyrë që fatura të jetë e vlefshme për qëllime tatimore;
- e. Plotëso faturat e shitjes me të gjitha të dhënat e kërkuara: datën, të dhënat e blerësit, emrin tregtar/emrin e individit, NIPT/Nr. personal, adresën, transportuesin, përshkrimin e mallit/shërbimit, njësinë, çmimin pa TVSh, vlerën pa TVSh, shumën e TVSh, etj;
- f. Bëj mbylljen e kasës fiskale, në fund të çdo dite pune dhe transmeto të dhënat e saj. Të nesërmen regjistrimi i kuponave fillon nga e para;
- g. Merr faturë tatimore të thjeshtë ose me TVSh (në varësi të përgjegjësisë tatimore të shitësit) për çdo blerje të kryer për biznesin tënd.

**Kujdes:** Për moslëshim të faturës, mosdokumentim të mallrave në ruajtje dhe lëvizje mallrash të pashoqëruar me dokumenta tatimore, në mënyrë të përsëritur, administrata tatimore të regjistron me detyrim si pagesues i Tatimit mbi fitimin;

Blerjet pa faturë tatimore ose vetëm me kupon tatimor, nuk njihen si shpenzime të zbritshme.

## 12. Deklarimi i të punësuarve dhe të larguarve nga puna dhe i pagave të tyre:

- a. marrja në punë dhe largimi nga puna deklarohen në llogarinë elektronike:
  - i. 1 ditë para marrjes në punë, dhe
  - ii. Brenda 10 ditëve nga data e largimit nga puna.
- b. Njihen si shpenzime vetëm pagat që paguhen nëpërmjet sistemit bankar.

## 13. Detyrimet tatimore që duhen paguar

Shuma e detyrimeve tatimore llogaritet duke shumëzuar shumën (bazën) mbi të cilën llogaritet tatimi me shkallën tatimore të caktuar për secilin lloj të tatimit.

**Tabela 2–Detyrimet tatimore për Personat Juridikë me xhiro vjetore mbi 2 - 5 milionë lekë**

Nr.	Lloji i Detyrimit	Shkalla tatimore	Shuma mbi të cilën zbatohet shkalla tatimore
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSh)	6% 20%	Vlera për shërbimin e akomodimit Vlera e mallrave/shërbimeve të tjera
2.	Kontribute për sigurime shoqërore të punëmarrësit	24.5%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale dhe jo mbi pagën maksimale mujore (24,000-105,850 lekë)
3.	Kontribute për sigurime shëndetësore të punëmarrësit	3.4%	Paga mujore faktike bruto por jo nën pagën minimale mujore (24,000 lekë)
4.	Tatim mbi të ardhurat nga punësimi të punëmarrësit	0% 13% 23%	Paga mujore bruto deri në 30,000 lekë; Pjesa e pagës mujore bruto mbi 30,000-130,000 lekë Pjesa e pagës mujore bruto mbi 130,000 lekë
5.	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	0%	Fitimi bruto (para tatimit)
6.	Tatim në burim	15%	Shuma bruto e pagesës për individë të peregjistruar

**Kujdes:** Në rast se xhiroja në një vit kalendarik, kalon kufirin 5 milionë lekë, duhet të deklarosh dhe të paguash tatimin e thjeshtuar mbi fitimin me shkallën tatimore prej 5%. Në vitin e parë të regjistrimit, llogaritja e xhiros bëhet duke shumëzuar muajt nga data e regjistrimit në QKB me xhiron proporcionale 416,667 lekë në muaj;

#### 14. Periudhat dhe mënyra e deklarimit të detyrimeve tatimore

Periudhat për të cilën bëhet deklarimi i detyrimeve tatimore varen nga lloji i detyrimit. Deklarimi i parë për detyrimet tatimore bëhet brenda datës 14 dhe 20 të muajit ose tremujorit pas muajit të regjistrimit, në varësi të llojit të detyrimit.

**Tabela 3 - Periudha dhe mënyra e deklarimit të detyrimeve tatimore**

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Afati i deklarimit	Mënyra e paraqitjes së deklaratës
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar	Tremujore	Online
2.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/TAP	Tremujore	Online
3.	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	Vjetore	Online
4.	Tatimi në burim	Mujore	Online

#### 15. Afatet e deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore

Afati i deklarimit të detyrimeve tatimore është i ndryshëm në varësi të llojit të detyrimit. Data e fundit e deklarimit është edhe data e kryerjes së pagesës. Më poshtë janë dhënë datat e fundit të deklarimit dhe pagesës së detyrimeve tatimore dhe vendi i kryerjes së pagesës.

**Tabela 4 - Afatet e deklarimit dhe pagesës si edhe vendi ku kryhet pagesa e detyrimeve tatimore**

Nr.	Lloji i Detyrimit Tatimor	Afati i deklarimit dhe pagesës së detyrimit	Vendi i pagesës
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar	Brenda datës 14 të muajit pas mbylljes së tremujorit	Në bankë
2.	Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore/TAP	Brenda datës 20 të muajit pas mbylljes së tremujorit (20 Prill; 20 Korrik; 20 Tetor; 20 Janar)	Në bankë
3.	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin	Brenda datës 10 shkurt të vitit pasardhës (Vetëm për deklarim dhe jo pagesë)	Nuk ka, Shkalla 0%
4.	Tatimi në burim	Çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës	Në bankë

**Kujdes:** Deklarata e TVSh, plotësohet në bazë të librit mujor të shitjes/blerjes, që dorëzohet online brenda datës 10 të tremujorit pasardhës;

Nëse detyrimet tatimore janë krijuar si rezultat i vlerësimit të bërë nga administrata tatimore duhet të paguhen brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

## 16. Ndryshimet e deklaratave tatimore për gabime ose pasaktësi bëhen nëse:

- a. Nuk kanë kaluar më shumë se 36 muaj nga deklarimi fillestar dhe nuk je kontrolluar nga administrata tatimore gjatë kësaj kohe;
- b. Je kontrolluar nga tatimet, por deklaron një detyrim tatimor më të madh se sa kontrolli;

## 17. Detyrimet mund të paguhen edhe me këste nëse:

- a. Je në vështirësi financiare;
- b. Lidh një marrëveshje për kushtet e pagesës me këste me DRT;
- c. Parapaguan 20% të detyrimit;
- d. Garanton mbylljen e detyrimeve brenda muajit Dhjetor të vitit pasardhës, në të kundërt marrëveshja nuk pranohet ose kërkohet të vendosësh garanci bankare.


**Kujdes:** Marrëveshja e pagesës me këste mund të priset në çdo kohë nëse:

1. Pagesat nuk bëhen në përputhje me marrëveshjen;
  2. Nuk paguan detyrimet e reja që lindin pas marrëveshjes;
- Nuk pranohet të lidhet marrëveshje e pagesës me këste për detyrim tatimor të vetëdeklaruar nga tatimpaguesi, i cili është llogaritur, ose mbledhur, ose mbajtur prej tij, përfshirë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

## 18. Detyrimet tatimore të paguara tepër rimbursohen ose kompensohen:

### A. Rimbursimet:

- a. Bëj kërkesë nëse rezulton me tepëri kreditore, në DPT për TVSh dhe në DRT për tatime të tjera;
- b. Merr miratimin nga



DPT, pas vlerësimit nga zyra ose me kontroll të thelluar në vend për TVSh;

c. Kërko dhe prit transferimin në llogarinë tënde bankare:

- i. Brenda pesë ditëve, pas dërgimit të urdhër-pagesës në sistemin e thesarit nga DPT;
- ii. Brenda 5 ditëve pas miratimit të shumës për rimbursim të bazuar në kontrollin në vend;
- iii. Brenda 30 ditëve, për diferencën pas mbulimit të detyrimeve të papaguara.

## **B. Kompensimet:**

a. Shuma e mbipaguar ose miratuar për rimbursim kalon për llogari të detyrimeve të tjera të papaguara:

- i. Brenda periudhës vijuese tatimore pas asaj në të cilën tatimpaguesi rezulton me kredi tatimore;
- ii. Për llogari të detyrimeve tatimore të ardhshme të tatimpaguesit.

**Kujdes:** Rimbursimi bëhet me një urdhër-pagesë në degën e thesarit, nga DPT për TVSh-në dhe DRT për tatimet e tjera, ndërsa kompensimi bëhet automatikisht për detyrimin e radhës të të njëjtit lloj dhe me miratim të posaçëm për llogari të detyrimeve të tjera, përveç mbipagesës së kontributeve për sigurimet.

## **19. Mosdeklarimi i detyrimit tatimor dhe mospagesa në afat kanë kosto:**

- a. Vendoset gjobë për mosdeklarim;
- b. Pas 5 ditëve, nga data e detyrimit për të deklaruar, administrata tatimore të njofton me letër kujtesë për detyrimin;
- c. Brenda 10 ditëve pas njoftimit administrata tatimore bën vlerësim automatik të deklaratës së munguar, i cili:
  - i. Nuk mund të ankimohet, por
  - ii. Mund të anulohet nëse paraqet deklaratën brenda afatit të ri të përcaktuar.
- d. Sistemi elektronik fillon llogaritjen automatike të gjobave dhe kamatëvonesave për detyrimin e papaguar.

## **20. Afati dhe pagesa e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore**

- a. Detyrimet për taksat dhe tarifave vendore përcaktohen me ligj dhe me Vendimet e Këshillave Bashkiake (VKB);
- b. Taksat vendore llogariten dhe paguhen në bazë vjetore, përveç vitit të regjistrimit ose pushimit/çregjistrimit të aktivitetit që llogariten proporcionalisht për periudhën e vitit fiskal që biznesi është aktiv;
- c. Taksat dhe Tarifave ndryshojnë sipas llojit të biznesit dhe natyrës së veprimtarisë së tij, por

më tipiket janë:

- i. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, ku përfshihen ndërtesat dhe tokat bujqësore;
- ii. Tarifat e pastrimit, zënies së hapësirave publike, tabelës dhe të tjera që vendosen me VKB.

## 21. Përgjegjësitë tatimore mund të ndryshojnë edhe pas regjistrimit fillestar

### a. Për TVSh-në:

- i. Në rast se xhiroja vjetore bie nën kufirin e regjistrimit për TVSh, çregjistrimi bëhet më një kërkesë drejtuar DRT, por hyn në fuqi 12 muaj pas datës së paraqitjes së kërkesës;

### b. Për tatimin mbi fitimin:

- i. Në rast se xhiroja në një vit kalendarik e kalon kufirin 8 milionë lekë, brenda 15 diteve nga data e tejkalimit të këtij kufiri duhet të bësh kërkesë për t'u regjistruar si pagues i tatimit mbi fitimin. Në vitin e parë të regjistrimit, llogaritja e xhiros bëhet duke shumëzuar muajt nga data e regjistrimit në QKB me xhiron proporcionale 666,667 lekë në muaj;

**Kujdes:** Nëse regjistrimi si pagues i tatimit mbi fitimin bëhet gjatë viti fiskal, për këtë vit duhet të bësh 2 deklarata: të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe të tatimit mbi fitimin;

Në varësi të fushës së aktivitetit, mund të duhet të regjistrohesh edhe për përgjegjësi tatimore të tjera specifike si p.sh. renta minerare.

## 22. Ndryshime të organizimit dhe vendndodhjes që duhen regjistruar në QKB

- a. Ndryshimi i emrit të shoqërisë, i aktivitetit, i adresës së selisë, administratorit, ortakëve, etj., që kryhen me vendim të ortakut;
- b. Hapja/mbyllja e adresave sekondare që kryhen me vendim të administratorit;
- c. Vendimet depozitohen në QKB nga administratori ose një person i autorizuar prej tij;



**Kujdes:** Mos fillo aktivitet në adresë dytësore, pa kryer më parë regjistrimin në QKB.

- Merr kasë fiskale për çdo adresë dytësore nëse kryen shitje me para në dorë.
- Konsiderohen si adresë dytësore edhe mjetet për:
  - a. Shitjen e mallrave derë më derë dhe
  - b. Transportin e mallrave dhe udhëtarëve për të tretë.
- Për mjetet e shoqërisë që përdoren vetëm për transportin e mallrave për vete ose blerësin tënd merr një vërtetim për posedim mjeti, online në portalin e-albania.

### **23. Mbajtja e të dhënave tatimore dhe kontabël**

- a. Dokumentat që duhet të mbahen për qëllime tatimore janë: faturat e blerjes dhe shitjes, librat e blerjeve dhe shitjeve, inventari i mallrave, libri i aktiveve të biznesit dhe çdo regjistrim tjetër i kërkuar nga ligji tatimor dhe i kontabilitetit;
- b. Dokumentat tatimore ruhen për një periudhë 5-vjeçare nga data e mbylljes së vitit fiskal.
- c. Kontabiliteti dhe përgatitja e pasqyrave financiare vjetore bazohen në ligjin për kontabilitetin dhe Standartet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-15);
- d. Pasqyrat Financiare ngarkohen online në llogarinë e tatimpaguesit brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës;
- e. Pasqyrat financiare dhe destinimi i fitimit pas tatimit, për vitin paraardhës, miratohen me vendim ortakut, brenda 6 muajve nga data e mbylljes së vitit financiar;
- f. Në rast se ka shpërndarje dividendi, deklarimi dhe pagesa e tatimit mbi dividendin bëhen brenda datës 20 gusht të vitit kur merret vendimi, pavarësisht nëse është bërë ose jo pagesa e dividendit.

### **24. Kontrolli tatimor**

- a. Administrata tatimore ka të drejtë të kontrollojë deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me pasqyrat financiare;
- b. Llojet e kontrollit tatimor janë:
  - i. Kontroll i thelluar në vend, me njoftim paraprak 30 ditë;
  - ii. Vizita fiskale, me njoftim paraprak 10 ditë;
  - iii. Verifikim në terren, pa njoftim paraprak por me një urdhër ditor të punës.

## 25. Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor bëhet kur:

- a. Detyrimet tatimore nuk janë paguar sipas afateve ligjore;
- b. Nuk ke ushtruar të drejtën e ankimit në Drejtorinë e Apelimit Tatimor (DAT);
- c. Kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

### Për mbledhjen ndërmerren këto hapa:

- i. Njoftimi i tatimpaguesit me kërkesë për të paguar / bllokimi i llogarive bankare / sigurimi i detyrimit tatimor me vendosjen e barrës siguruese dhe/ose barrës hipotekore / sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së bllokuar / shitja e pasurisë së sekuestruar / kalimi i përgjegjësisë për detyrimin e papaguar tek palët e treta, administratorët dhe ortakët.
- ii. Pas dërgimit të Njoftimit dhe kërkesës për Pagesë, mund të merret masa e konfiskimit deri në 50% të xhiros ditore;
- iii. Kërkohet pezullim i veprimeve në QKB dhe Doganë.

## 26. Ankimimi bëhet:

- a. Pranë DAT të Ministrisë së Financave dhe të Bashkisë;
- b. Për vlerësimet e bëra nga administrata tatimore dhe çdo vendim tjetër që ndikon në detyrimin tatimor, përveç vlerësimit të bërë në mungesë të deklaratës tatimore;
- c. Brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit;
- d. Pas pagesës ose vendosjes së garancisë për detyrimin që ankimohet përfshirë kamatën, por jo për gjrobat;
- e. Edhe në rrugë gjyqësore kur akti është ankimuar më parë në rrugë administrative.

## 27. Gjrobat dhe kamatëvonesat:

- a. Vendosen për deklarime dhe pagesa të detyrimeve tatimore përtej afateve ligjore;
- b. Aplikohen edhe për fshehje të detyrimit, moslëshim të faturave të shitjes dhe/ose kuponit tatimor, mosdeklarim të pagës reale, plotësim të gabuar të deklaratave tatimore, mosinstalimin dhe mosmirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, mosdeklarim të punonjësve, mosmbajtje të dokumentave tatimore/kontabël, etj.;
- c. Zbatohen të dyja së bashku, por kamatëvonesat fillojnë nga afati i pagesës dhe ndërpriten në datën e pagesës së detyrimit;
- d. Ndërsa gjrobat mund të ankimohen, kamatëvonesat jo.

**Kujdes:** Fshehja apo shmangia nga pagimi i detyrimeve tatimore, për shkaqet e mësipërme, përveçse klasifikohen si evazion fiskal mund të bëhen edhe objekt i ndjekjes penale.

## 28. Kalimi në statusin pasiv tatimor:

- a. mund të bëhet vetëm nga DRT nëse:
  - i. Pezullon aktivitetin në QKB, me vendim të ortakut, për një afat të caktuar ose jo;
  - ii. Nuk dorëzon deklaratën tatimore përgjatë 12 muajve të fundit;
  - iii. Dorëzon deklaratat tatimore pa aktivitet për 12 muaj të njëpasnjëshëm;
- b. Të lejon ndërprerjen e deklaratave për të gjithë llojet e detyrimeve tatimore;
- c. Kërkon dorëzimin në DRT të numrave serial të blloqeve të faturave të shitjes të papërdorura.

### **Kujdes:**

- a. Në statusin pasiv nuk mund të kryesh asnjë aktivitet;
- b. Nëse ke detyrime deri në kalimin në statusin pasiv, ato duhet të paguhen;
- c. Duhet të dorëzosh deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe Pasqyrat Financiare për muajt e vitit në aktivitet.
- d. Për rifillimin e aktivitetit duhet të dorëzosh vendimin e ortakut në QKB. Kur kalimi në statusin pasiv është bërë direkt nga DRT, riaktivizimi bëhet me kërkesë pranë administratës tatimore.

## 29. Çregjistrimi bëhet:

- a. Vullnetarisht, me vendim të ortakut për çregjistrim, me procedurë likuidimi në QKB;
- b. Me vendim gjyqate, me anë të të cilit vendoset çregjistrimi i subjektit:
  - i. Në vijim të ndjekjes së procedurave të likuidimit në rrugë gjyqësore, ose
  - ii. Në vijim të ndjekjes së procedurave të falimentimit.

**Kujdes:** Administrata tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin kur ke detyrime të papaguara, nuk ke paraqitur pasqyrat financiare dhe nuk ke dorëzuar deklaratat tatimore deri në mbyllje të procesit të likuidimit. Edhe pas çregjistrimit mbetesh përgjegjës për detyrimet e mbetura ndaj të tretëve dhe ndaj autoriteteve publike. Dorëzo pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore blloqet e faturave të shitjes të papërdorura. Pas çregjistrimit në QKB, kontakto shoqërinë e autorizuar të kasës fiskale për çaktivizimin e saj.

Ky material është përgatitur në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe përmban informacion mbi të drejtat dhe detyrimet tatimore për kategorinë:

**Person Juridik me xhiro  
mbi 2 deri 5 milionë Lekë**

Qendra e thirrjeve: 0800 00 02 (pa pagesë).

Orari: E Hënë - E Enjte ora 08:30 - 18:00; E Premte ora 08:30 - 16:00

 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Web: [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)



**European Bank**  
for Reconstruction and Development



**DREJTORIA E  
PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE**